



# **Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë**

---

## **Vala e dytë**

**Përmbledhje e gjetjeve për Qarkun e Tiranës**

**SHTATOR 2022**

**Autorët:** [Deanna Davy](#), Konsulente Ndërkombëtare për UNICEF-in në Shqipëri  
[Blerina Metanji](#), IDRA Albania

**Menaxhere Studimi:** [Elda Denaj](#), Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit në UNICEF Shqipëri

**Redaktor:** [Iain Wilson](#)

Ky dokument u përgatit në kuadrin e Programit “*Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria*”, zbatuar nga një koalicion prej gjashtë organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare: UNICEF-i në Shqipëri, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Terre des Homme, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Programi u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (MB).

Pikëpamjet e shprehura në raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të UNICEF-it ose qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materiale nga ky raport për botimet e tyre, me kushtin që të citojnë burimin.

**Citim i sugjeruar i raportit:**

Davy, D., dhe Metanji, B. (2022) “*Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë: Vala e dytë. Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Tiranës*” UNICEF në Shqipëri dhe IDRA..

Për komente, korrigjime dhe sugjerime, ju lutemi, na shkruani në adresën: [tirana@unicef.org](mailto:tirana@unicef.org)

# **Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë**

**Vala e dytë**

Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Tiranës

Shtator 2022





## TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE.....	4
2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT .....	5
3. METODOLOGJIA.....	6
4. GJETJE.....	7
5. PËRFUNDIME.....	22

# 1. HYRJE

Shqipëria është prekur ndjeshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe vazhdon të zhvillojë një sërë politikash dhe mekanizmash për ta luftuar këtë fenomen. Vendi njihet si vendburim për trafikimin e qenieve njerëzore. Shqiptarët trafikohen shpesh drejt Italisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Gjermanisë dhe Zvicrës nëpërmjet rrjeteve të organizuara kriminale. Ndërkohë, trafikimi brenda vendit vijon të jetë një fenomen i konsiderueshëm prej rreth dy dekadash, shumica e viktimave vendase të të cilit janë fëmijë dhe të rinj. Shumë viktime shqiptare vijnë nga familje të varfra, janë të papunë dhe me mangësi në arsimim. Për fëmijët dhe të rinjtë e trafikuar, faktorët e riskut e kanë zanafillën kryesisht nga situatat familjare, dhe përfshijnë braktisjen ose shpërbërjen e familjes. Pasojë e këtyre faktorëve është fakti që atyre iu mungojnë rrjetet e rëndësishme të sigurisë mbrojtëse.

Pavarësisht të dhënave të qarta se të rinjtë shqiptarë janë të cenueshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore, ka mungesë literature për nivelin e njohurive të tyre për këtë fenomen brenda vendit, ose për qëndrimet dhe praktikën e tyre lidhur me të. Vetëm një studim i fundit (2016) trajton njohuritë dhe ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri.<sup>1</sup> Nga ai studim, kuptojmë se të rriturit shqiptarë janë më të ndërgjegjshëm rreth trafikimit për qëllime seksuale sesa rreth trafikimit për qëllime pune; më shumë se gjysma e të rriturve shqiptarë të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është problem serioz, por prek kryesisht gratë dhe fëmijët; dhe se shumë persona nuk dinë se si mund t'i ndihmojnë viktimat e mundshme.

Duke qenë se ai studim nuk trajtoi posaçërisht nivelin e njohurive të të rinjve, ose qëndrimet dhe praktikën e tyre lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, studimi aktual e shqyrton këtë çështje me qëllim plotësimin e mangësive të rëndësishme në njohuri. Rezultatet e studimit do të jenë të dobishme për qeverinë dhe palët joqeveritare të interesit që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Studimi aktual është një anketë e valës së dytë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të vendit, dhe të romët. Kjo anketë pason atë të valës së parë, rezultatet e së cilës u publikuan në dhjetor të vitit 2020.<sup>2</sup> Kjo anketë e valës së dytë përsërit pyetjet e valës së parë në masën maksimale të mundshme.

Ky raport përqendrohet vetëm te qarku i Tiranës në Shqipëri, për të krahasuar rezultatet e anketës në Dibër me ato të tre qarqeve të tjera: Dibër, Kukës dhe Shkodër. Një raport i përgjithshëm që paraqet gjetjet e anketës është publikuar, së bashku me katër raportet rajonale dhe një raport për të rinjtë romë. Për analizë të mëtejshme, të dhënat e mbledhura nga anketa e valës së dytë mbahen dhe vizualizohen në një panel të posaçëm.<sup>3</sup>

Paraqitja e rezultateve në nivel qarku është hartuar për të udhëhequr zhvillimin e përpjekjeve të komunikimit për trafikimin e qenieve njerëzore të përshtatura sipas kontekstit. Krahasimi këtu nuk bëhet ndërmjet rezultateve të anketës së valës së parë dhe të valës së dytë pasi ndryshimet në njohuri, qëndrime dhe praktika janë minimale. Duhet theksuar se aty ku nuk trajtohen të dhënat në tabela dhe shifrat, kjo ka të bëjë me faktin se ndryshimet janë të papërfillshme.

---

<sup>1</sup> USAID, 2016, Matja e opinionit publik lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Moldavi dhe Shqipëri duke përdorur anketa eksperimentuese për të informuar rreth programeve efektive të parandalimit dhe ndërgjegjësimin.

<sup>2</sup> Davy, D., dhe Metanji, B., 2020, [Anketë e valës së parë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë. Raport për gjetjet](#). Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, IDRA, UNICEF në Shqipëri:

<sup>3</sup> [Paneli i studimit](#)

## 2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Nëpërmjet këtij studimi synohet të kuptohet dhe eksplorohet niveli i <sup>4</sup>njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në qarqet Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë, si dhe te të rinjtë romë.

Objektivat e studimit ishin krahasimi i diferencave në nivelet e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve të anketuar në katër qarqe:

### **Njohuritë**

- Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore
- Format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe në vende të huaja
- Kush është në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore
- Metodot e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore
- Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore
- Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat

### **Qëndrimet**

- Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore
- Qëndrimet ndaj viktimave

### **Praktikat**

- Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore
- Interesi për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore

### 2.1 Rezultatet e komunikimeve të UNICEF-it

- Ekspozimi ndaj materialeve për komunikim mbi trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve
- Rritja e njohurive, qëndrimeve dhe interesit për t'u angazhuar në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rrjedhojë e ekspozimit.

### 2.2 Struktura e raportit

Pas këtij seksioni hyrës, raporti paraqet metodologjinë e studimit, e pasuar nga gjetjet mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Raporti mbyllet me një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore.

---

<sup>4</sup> Grupmosha 15–29 vjeç, sikurse përcaktohet nga Komisioni Evropian. Shihni EUROSTAT, Të rinjtë - Vështrim i përgjithshëm, <https://ec.europa.eu/eurostat/web/youth>.

## 3. METODOLOGJIA

### 3.1 Qasja ndaj anketës

Për studimin aktual janë anketuar rreth 1,600 të rinj (Tabela 1), duke përfshirë plotësues të anketës të grupmohës 15-29 vjeç që jetojnë në Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë (350 të anketuar në secilin qark). Kampioni përfshiu një kampion plotësues prej 200 të rinjsh të popullatës rome që jetojnë në Kukës, Shkodër dhe Tiranë. Të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Të dhënat zyrtare<sup>5</sup> tregojnë se janë në total rreth 300,000 persona të moshës 15-29 vjeç që jetojnë në qarqet ku u krye studimi. Si rrjedhojë, përmasa e kampionit të rreth 1,600 plotësuesve të anketës garanton rezultate përfaqësuese në nivel kombëtar me marzh gabimi prej 2.62% dhe me interval besueshmërie prej 95%. Kufiri i gabimit në nivel qarku është 5.24% me interval besueshmërie prej 95% (shihni Aneksin për një vështrim të përgjithshëm të metodologjisë). Anketa u zhvillua nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë. Vetëm një person për familje, i grupmohës 15-29, u ftua të merrte pjesë. Përzgjedhja rastësore e familjeve u bë nëpërmjet një softueri. Mbledhja e të dhënave u krye gjatë periudhës 14 janar deri në 1 mars 2022 nga intervistues të trajnuar të IDRA Research & Consulting. Çdo intervistë zgjati rreth 20 minuta.

Tabela 1. Numri i intervistave të anketës të kryera në secilin qark të synuar dhe me romët

Qarku	Nr.
Tiranë	350
Shkodër	350
Kukës	341
Dibër	346
<b>Totali, 4 qarqe</b>	<b>1,387</b>
Rom/e	200
<b>Totali i të anketuarve (Nr.)</b>	<b>1,587</b>

Anketa u zhvillua nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë. Vetëm një person për familje, i grupmohës 15-29, u ftua të merrte pjesë. Përzgjedhja rastësore e familjeve u bë nëpërmjet një softueri. Mbledhja e të dhënave u krye gjatë periudhës 14 janar deri në 1 mars 2022 nga intervistues të trajnuar të IDRA Research & Consulting. Çdo intervistë zgjati rreth 20 minuta.

### 3.2 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u krye nga IDRA duke përdorur paketën softuerike të të dhënave statistikore IBM SPSS 25. Të dhënat u ponderuan për të qenë përfaqësuese për secilin qark dhe në tërësi. Kjo u bë në mënyrë që kontributi i plotësuesve të anketës nga secili qark të ishte përpjesëtimor me shifrat e popullsisë së qarkut. Rezultatet u ndanë sipas treguesve demografikë kryesorë, si gjinia dhe mosha.

### 3.3 Konsiderata etike

Anketa për trafikimin e qenieve njerëzore nuk përmbante pyetje të vështira ose të ndjeshme për të rinjtë. Megjithatë, u krye një vlerësim i etikës, pasi të dhënat u mbledhën nga fëmijë të grupmohës 15-17 vjeç dhe më të rritur (18-29 vjeç). Përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, studimi mori miratimin etik nga Health Media Lab. Ltd. Bordi i Kërkimit Etik.6 Për këtë studim, ekipi respektoi sa më poshtë:

- Rregulloren “Për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese”, dhe, në veçanti, nenin 1.1.4, që u kërkon institucioneve “të ruajnë një klimë bashkëpunimi që nxit përgjegjshmëri dhe etikë në kërkim”. Ky udhëzim (rregullore) u nxor nga Qeveria e Shqipërisë për të orientuar çështjet e lidhura me etikën për shoqëritë, institucionet dhe konsulentët që kryejnë punë kërkimore.
- Procedurat e UNICEF-it për Standardet Etike në Kërkim, Vlerësim, Mbledhje dhe Analizë të Dhënash (2021).

Ekipi i kërkimit respektoi standardet e mëposhtme themelore:

- subjektet nuk vihen në risk të tepruar;
- pjesëmarrja është vullnetare, dhe subjektet informohen dhe u sigurohet një formë pëlqimi, me të cilën duhet të bien dakord paraprakisht; dhe
- ekzistojnë protokolle me shkrim për të siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, intervistuesit ndanë fletëpalosje me pjesëmarrësit në anketë dhe familjet e tyre, duke përfshirë informacion për shërbimet mbështetëse për kujdesin mendor dhe psikologjik, dhe kanalet e raportimit për trafikimin e qenieve njerëzore.

<sup>5</sup> Instituti i Statistikave i Shqipërisë: [Rezultatet e Censurit të 2011](#); aksesuar për herë të fundit në korrik 2022:

<sup>6</sup> See <https://www.healthmedialabirb.com/>.



## 4. GJETJE

### 4.1 Profili i të rinjve të anketuar në Tiranë

Nga 350 të rinj romë plotësues të anketës, 55% ishin femra dhe 45% ishin meshkuj (Figura 1). Shumica e të rinjve të anketuar në Tiranë (58%) ishin të moshës 18–24 vjeç, 15% ishin 15–17 vjeç dhe 27% ishin 25–29 vjeç (Figura 2).

Figura 1. Plotësuesit e anketës sipas seksit






Figura 2. Plotësuesit e anketës sipas grupmoshës.



Shumica (67%) e të rinjve të anketuar në Tiranë jetonin në zona urbane dhe pjesa tjetër (33%) në zona rurale (Figura 3).

Figura 3. Plotësuesit e anketës sipas urbanitetit




### 4.2 Njohuri rreth trafikimit të qenieve njerëzore

#### Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore

**Të dhënat e anketës tregojnë se shumica e të rinjve mendojnë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në vende të huaja (Figura 4). Megjithatë, të rinjtë kanë më pak njohuri se trafikimi ndodh brenda Shqipërisë dhe edhe më pak prej tyre dinë që ndodh në komunitetin ose zonën e tyre.** Pesëdhjetë e pesë për qind e të rinjve të anketuar në Tiranë mendojnë se trafikimi i shtetasve shqiptarë në vende të huaja ndodh në masë të madhe ose shumë të madhe, ndërsa 44% mendojnë se ndodh në Shqipëri në masë të madhe ose shumë të madhe. **Vetëm 13% mendojnë se ky fenomen ndodh në komunitetin apo zonën e tyre në masë të madhe apo shumë të madhe. Në çdo rast, ka më shumë të rinj në Tiranë se në katër qarqet që e dinë se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore.**


Figura 4. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë



**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, në ç'masë ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (shtetasve shqiptarë) në vende të huaja, në Shqipëri dhe në komunitetin ose zonën tuaj? Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Nga të rinjtë në Tiranë, femrat kanë më shumë dijeni se meshkujt se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 5), nga të cilat më shumë se gjysma (54%) dhe një e treta (34%), përkatësisht, kanë dijeni për dukurinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë në Shqipëri. Për më tepër, 16% e femrave kanë dijeni për ndodhshmërinë e trafikimit të qenieve njerëzore në komunitetin ose zonën e tyre, në krahasim me vetëm 9% të meshkujve.**


Figura 5. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas seksit



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Të rinjtë e moshës 25-29 vjeç kanë më shumë njohuri se të rinjtë e tjerë në lidhje me vendin ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 6), p.sh., vetëm 43 përqind e 15-17-vjeçarëve mendojnë se trafikimi ndodh në vendet e huaja, krahasuar me 57% të 25-29-vjeçarëve.**


Figura 6. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Njohuria rreth trafikimit të qenieve njerëzore që ndodh në Shqipëri dhe në vendet e huaja është më e madhe te të rinjtë e anketuar në zonat rurale të Tiranës se te të rinjtë e zonave urbane (Figura 7) me përkatësisht 51% dhe 40% që mendojnë se ndodh në masë të madhe dhe shumë të madhe në Shqipëri.**

Figura 7. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas urbanitetit.



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Tiranë.

### Format e shfrytëzimit të shqiptarëve në Shqipëri dhe jashtë vendit

**Të rinjtë e anketuar në Tiranë kanë më shumë njohuri se popullata e anketuar në katër qarqet e vendit lidhur me format e shfrytëzimit që përdoren në Shqipëri dhe jashtë vendit, me më shumë se 70% të të rinjve të Tiranës që kanë njohuri për çdo formë shfrytëzimi të përmendur te Tabela 2 që ndodh në Shqipëri.**

Tabela 2. Njohuritë për format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit (%)

Forma e shfrytëzimit	Në Shqipëri		Jashtë vendit	
	Total, Tiranë	Totali, 4 qarqe	Total, Tiranë	Totali, 4 qarqe
shfrytëzimi seksual i të rriturve	82	80	81	76
shfrytëzimi seksual i fëmijëve	89	87	78	73
puna e detyruar e të rriturve	72	70	71	67
puna e detyruar e fëmijëve	86	83	73	70
martesa e detyruar	72	67	65	56
martesa e hershme	88	85	65	57
lypja e detyruar e të rriturve	75	66	64	56
lypja e detyruar e fëmijëve	96	93	84	76
kriminaliteti i detyruar i të rriturve	85	81	86	81
kriminaliteti i detyruar i fëmijëve	89	83	82	76
<b>N.</b>	<b>350</b>	<b>1,387</b>	<b>350</b>	<b>1,387</b>

**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, a ndodhin format e mëposhtme të shfrytëzimit, që përfshijnë shtetasit shqiptarë, në Shqipëri dhe në vende të huaja? Tabela tregon përqindjet vetëm për alternativën e përgjigjes "po". **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

### Grupet në rrezik nga trafikimi i qenieve njerëzore

**Rezultatet e anketës tregojnë se ka një perceptim të anshëm gjinor te të rinjtë e Tiranës lidhur me grupet e personave në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Tabela 3). Grupi që konsiderojnë më në risk janë vajzat nën moshën 18 vjeç, me 82% që e konsiderojnë këtë grup në risk të madh ose shumë të madh për t'u trafikuar, krahasuar me 77% të popullatës në tërësi. Ata i konsiderojnë minoritetet kombëtare si grupin e dytë më në risk, me 51% që mendojnë se janë në risk të madh ose shumë të madh, krahasuar me 47% të popullatës në tërësi. Ndërkohë, 42% e të rinjve të Tiranës mendojnë se femrat 18 vjeç e lart janë në risk të madh ose shumë të madh për t'u trafikuar, krahasuar me 37% të popullatës së anketuar në tërësi. Megjithatë, **vetëm katër për qind të të rinjve të Tiranës mendojnë se burrat janë në risk të madh për t'u trafikuar, krahasuar me pesë për qind të popullsisë në tërësi.****


Tabela 3. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar (%)

Grupi i popullatës	Total, Tiranë	Totali, 4 qarqe
gra (18 dhe mbi 18 vjeç)	42	37
vajza (nën 18 vjeç)	82	77
burra (18 dhe mbi 18 vjeç)	4	5
djem (nën 18 vjeç)	28	26
pakica kombëtare	51	47
persona nga zona rurale	36	30
<b>N.</b>	<b>350</b>	<b>1,387</b>

**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, në ç'masë mendoni se secili nga grupet e mëposhtme janë në risk të konsiderueshëm ose të lartë për t'u trafikuar? Tabela tregon përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Në Tiranë, femrat kishin më shumë njohuri sesa meshkujt lidhur me grupet më në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 8).** Për shembull, 90% e femrave kishin njohuri që vajzat nën moshën 18 vjeç kanë risk të lartë ose shumë të lartë për t'u trafikuar, krahasuar me 73% të meshkujve. Në anën tjetër, pak më shume meshkuj (29%) se femra (27%) mendojnë se djemtë nën moshën 18 vjeç janë po ashtu në risk të lartë ose shumë të lartë.


Figura 8. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Ndër të rinjtë e Tiranës, askush prej 25-29 vjeçarëve të intervistuar nuk e dinin që burrat 18-vjeçarë apo mbi këtë moshë janë në risk për t'u trafikuar (Figura 9).**


Figura 9. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Në Tiranë, të rinjtë nga zona urbane kanë më pak njohuri se të rinjtë nga zona rurale rreth atyre që janë në risk për t'u trafikuar (Figura 10), veçanërisht për sa u përket minoriteteve kombëtare, me përkatësisht 42% dhe 69% që mendojnë se ky grup është në risk të lartë ose shumë të lartë.**

Figura 10. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas urbanitetit.



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore**

Me qëllim vlerësimin e njohurive të të rinjve të anketuar në Tiranë sa u përket metodave të rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore, të rinjtë u pyetën nëse ishin dakord me disa pohime lidhur me metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore. Rezultatet (Tabela 4) tregojnë se të rinjtë e Tiranës kanë njohuri të tilla, edhe pse **më pak prej tyre se popullata në tërësi e dinë se anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë qeniesh njerëzore (përkatësisht 42% dhe 48%).**


Tabela 4. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore (%)

Metoda e rekrutimit	Total, Tiranë	Totali, 4 qarqe
Trafikantët janë pjesë e rrjeteve të organizuara kriminale	89	90
Për të rekrutuar viktimë mund të përdoret interneti	95	94
Trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë shokët	86	86
Trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë anëtarët e familjes	43	48
Trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë të dashurit ose të dashurat	87	85
<b>N.</b>	<b>350</b>	<b>1,387</b>

**Pyetje ankete:** Në ç'masë jeni dakord ose jo me pohimet e mëposhtme? Tabela raporton përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Në grupin e të rinjve të anketuar në Tiranë, femrat kanë njohuri më të qarta se meshkujt rreth metodave të rekrutimit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikantëve të qenieve njerëzore** (Figura 11). Për shembull, 47% të femrave mendojnë se anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë qeniesh njerëzore, krahasuar me 39% të meshkujve.


Figura 11. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Në përgjithësi, 18-24-vjeçarët janë më të ndërgjegjshëm se kush mund të jetë trafikant qeniesh njerëzore se të rinjtë e tjerë** (Figura 12). Për shembull, vetëm 36% të 15-17-vjeçarëve mendojnë se anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë qeniesh njerëzore, krahasuar me 45% të 18-24 dhe 25-29-vjeçarëve.


Figura 12. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Në Tiranë, më shumë të rinj nga zona rurale (53%) se të rinjtë nga zona urbane (38%) e dinë që anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë qeniesh njerëzore** (Figura 13).

Figura 13. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas urbanitetit




Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Tiranë.

### Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore

**Në përgjithësi, të rinjtë në Tiranë kanë më shumë njohuri se popullata në katër qarqe për mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore** (Figura 14). Për shembull, gati nëntë të dhjetat e të rinjve të Tiranës (89%) e dinë se mund t'i raportojnë raste të tilla në polici, krahasuar me 85% të popullatës në tërësi, dhe 84% dhe 75%, përkatësisht, që mund të raportojnë raste të tilla nëpërmjet linjës telefonike 129 të policisë.

Figura 14. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, cili nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore? Disa. **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Në Tiranë, të rejtat dinë më shumë se të rinjtë rreth mënyrave për të raportuar raste të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore** (Tabela 5). Ndërkohë, ka më shumë të rinj 15-17-vjeçarë se të rinj të tjerë që e dinë se mund t'i raportojnë një rast të dyshuar një mësuesi, psikologu ose profesionisti tjetër të shkollës (62%, krahasuar me 38% të 18-24-vjeçarëve dhe 28% të 25-29-vjeçarëve). **Në Tiranë, të rinjtë nga zona urbane dinë më shumë se të rinjtë nga zona rurale rreth mënyrave për të raportuar raste të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore**, edhe pse të rinjtë nga zona rurale janë më të ndërgjegjshëm se mund t'i raportojnë rastet e dyshuara një mjeku apo infermieri, organizatave jofitimprurëse dhe një punonjësi të mbrojtjes së fëmijës. Vetëm shtatë për qind të të rinjve nga zona urbane në Tiranë e dinë që mund të t'i raportojnë një rast të dyshuar një mjeku apo infermieri, krahasuar me njëzet për qind të të rinjve nga zona rurale në Tiranë.


Tabela 5. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore, sipas seksit, grupmoshës, dhe urbanitetit (%).

Ku të raportoni raste trafikimi	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
rajon policie	90	89	90	90	88	90	87
linja telefonike e policisë 129	81	87	89	80	89	85	81
mësues, psikolog, profesionist tjetër në shkollë	42	36	62	38	28	39	39
punonjës i mbrojtjes së fëmijës	21	14	20	20	12	17	19
organizatë jofitimprurëse	17	13	8	17	14	14	18
mjek ose infermier	10	13	15	11	11	7	20
linja kombëtare për këshillimin e fëmijëve ALO 116	14	11	15	14	9	13	12
linja telefonike kombëtare (116 006)	14	8	13	11	8	11	10
aplikacion telefonik ('Telefono, Raporto!')	11	6	7	9	9	10	7
profesionist tjetër në bashki ose njësinë administrative	8	5	6	8	6	9	2
nuk pranoj të përgjigjem	1	0	0	0	2	0	1
tjetër	0	1	0	1	0	0	0
asnjëra nga alternativat e mësipërme	0	1	0	1	0	0	0
<b>N</b>	<b>192</b>	<b>158</b>	<b>53</b>	<b>203</b>	<b>94</b>	<b>233</b>	<b>117</b>

**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, cili nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore? Disa. Popullata e synuar: Tiranë.

**Më shumë se gjysma (54%) e të rinjve në Tiranë janë të ndërgjegjshëm për të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore, krahasuar me 49% të popullatës së përgjithshme (Figura 15). Raportimi ballë për ballë është mënyra e preferuar e të rinjve të Tiranës për raportimin e rasteve të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore (Tabela 6) me 68% të tyre që preferojnë t'ua raportojnë rastet e dyshuara drejtpërdrejt oficerëve ligjzbatues, krahasuar me 72% të popullatës në tërësi.**

Figura 15. Njohuri për të paktën tri mënyra për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore



Popullata e synuar: Tiranë; Totali, 4 qarqe.

Tabela 6. Kanalet e parapëlqyera të raportimit të një rasti të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore (%)

Mënyrat e raportimit të rastit të trafikimit	Total, Tiranë	Totali, 4 qarqe
ballë për ballë tek institucionet ligjzbatuese (polici, prokurori)	68	72
shërbimet telefonike (linjat e këshillimit, linjat e ndihmës)	38	36
raportimi ballë për ballë tek institucionet joligjzbatuese	19	24
OJF e specializuar për çështjen	10	12
platformë në internet, aplikacion telefoni	9	9
asnjëra nga alternativat e mësipërme	4	4
nuk e di	0	1
<b>N.</b>	<b>350</b>	<b>1,387</b>


**Pyetje ankete:** Cilin nga kanalet e mëposhtme do të konsideroni ose do të parapëlqenit për raportimin e një rasti trafikimi qeniesh njerëzore? Disa. Popullata e synuar: Tiranë; Totali, 4 qarqe.

### Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë në Tiranë, sikurse dhe popullata në tërësi, kanë njohuri të kufizuara rreth shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, me **26% prej tyre që nuk kanë asnjë njohuri për asnjë lloj mbështetjeje të tillë.** (Figura 16).



Figura 16. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri



**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, cilat nga llojet e mëposhtme të mbështetjes janë të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri? Disa. **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Ndër të rinjtë e Tiranës, femrat kanë më shumë dijeni se meshkujt rreth tipave të mbështetjes së disponueshme në Shqipëri për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 7). Në veçanti, femrat (40%) e dinë më shumë se meshkujt (20%) se ka shërbim psiko-social të disponueshëm. Vetëm 18% e femrave janë të pandërgjegjshme për ekzistencën e ndonjë tipi të tillë mbështetjeje, krahasuar me 35% të meshkujve.**

**Të rinjtë e moshës 25-29 vjeç kanë më pak njohuri se të rinjtë e tjerë për tipat e disponueshëm të mbështetjes për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Vetëm 31% e tyre kanë dijeni për mbështetjen e posaçme nga policia e shtetit, krahasuar me 59% të 15-17-vjeçarëve; dhe vetëm 18% e tyre kanë njohuri për disponueshmërinë e mbështetjes psiko-sociale, krahasuar me 37% të 18-24-vjeçarëve. Për më tepër, 33% e tyre nuk kanë asnjë njohuri rreth tipave të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 25% të 15-17-vjeçarëve dhe 24% të 18-24-vjeçarëve. Të rinjtë që jetojnë në zona rurale në Tiranë kanë më shumë njohuri se të rinjtë në zona urbane rreth tipave të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Për më tepër, 35% e të rinjve në zona urbane s'kanë dijeni për asnjë tip mbështetjeje, krahasuar me vetëm 9% të të rinjve në zona rurale.**

Tabela 7. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit(%)


Tipi i mbështetjes për viktimat	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
mbështetje e posaçme nga policia e shtetit	45	44	59	47	31	41	52
mbështetje psiko-sociale (shëndeti mendor)	40	20	27	37	18	26	39
mbështetje sociale nga qeveria	28	28	34	25	31	26	32
mbështetje sociale nga OJF-të	20	18	15	19	22	19	20
mbështetje për strehim	22	18	18	24	12	18	23
Këshillim/mbështetje nga linjat telefonike të këshillimit	22	15	32	16	17	15	26
akomodim në strehë	21	15	22	18	17	18	19
mbështetje financiare	16	16	28	15	13	13	22
mbështetje për punësim	14	13	18	15	9	11	19
mbështetje mjekësore	14	11	15	14	6	8	21
këshillim për të drejtat ligjore/shërbimet e disponueshme	9	9	17	9	7	11	7
mbështetje e posaçme për trajnim ose arsimim	5	3	6	5	1	4	5
nuk e dinte ose nuk u përgjigj	18	35	25	24	33	35	9
<b>N.</b>	<b>192</b>	<b>158</b>	<b>53</b>	<b>203</b>	<b>94</b>	<b>233</b>	<b>117</b>

**Popullata e synuar:** Tiranë.



Ndërmjet të rinjve në Tiranë, **40% janë të ndërgjegjshëm për të paktën tre tipa mbështetjeje të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 39% të popullatës në tërësi** (Figura 17).

Figura 17. Njohuri rreth të paktën tri formave të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri




**Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

### 4.3 Qëndrimet lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

#### Niveli i shqetësimit

**Të rinjtë në Tiranë janë më të shqetësuar se popullata në tërësi për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri (përkatësisht 75% dhe 69% janë jashtëzakonisht të shqetësuar ose shumë të shqetësuar; Figura 18).**


Figura 18. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri



**Pyetje ankete:** Sa i/e shqetësuar jeni për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri? **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Të rejtat në Tiranë janë më të shqetësuar se të rinjtë për trafikimin e qenieve njerëzore (përkatësisht 87% dhe 63% janë jashtëzakonisht të shqetësuar ose shumë të shqetësuar; Figura 19).**


Figura 19. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit



**Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. Popullata e synuar:** Tiranë.

**Të rinjtë e moshës 15-17 vjeç në Tiranë janë më të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore sesa grupmoshat e tjera (59% jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar, krahasuar me 78% të grupmoshës 18-24 vjeç dhe 78% të grupmoshës 25-29 vjeç; Figura 20).**


Figura 20. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas grupmoshës



**Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. Popullata e synuar:** Tiranë.

**Figura 21 tregon se të rinjtë në zona urbane (75%) kanë një nivel të ngjashëm shqetësimi me të rinjtë në zona rurale (77%) për trafikimin e qenieve njerëzore.**

Figura 21. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Të rinjtë në Tiranë janë më të shqetësuar (shih Tabelën 8) për mungesën e zbatimit të ligjit (73%) dhe rritjen e trafikimit të fëmijëve dhe të rinjve (70%), prej të cilëve femrat janë më të shqetësuar se meshkujt për këtë çështje (përkatësisht 75% dhe 63%). Nga ana tjetër, të rinjtë janë më të shqetësuar se të rejtat për mungesën e zbatimit të ligjit (përkatësisht 76% dhe 70%).**

**Të rinjtë nga zona rurale në Tiranë janë më pak të shqetësuar se të rinjtë nga zona urbane për shumicën e aspekteve të trafikimit të qenieve njerëzore.** Për shembull, 41% e të rinjve nga zona rurale janë të shqetësuar për mbështetjen e pamjaftueshme për viktimat, krahasuar me vetëm 25% të të rinjve nga zona urbane dhe 35% e të parëve janë të shqetësuar për rritjen e trafikimit të rriturve, krahasuar me vetëm 20% të të fundit.

Tabela 8. Fushat më kryesore të shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, sipas seksit, grupmoshës dhe vendbanimit (%)


Fusha e shqetësimit	Totali		Tiranë						
			Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
	Tiranë	4 qarqe	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
mungesa e zbatimit të ligjit	73	72	70	76	76	68	80	73	71
rritja e trafikimit të fëmijëve e të rinjve	70	63	75	63	80	67	71	69	71
rritja e trafikimit të të rriturve	53	28	55	52	48	53	57	57	46
besueshmëria e ulët të institucionet përkatëse ku raportohen raste të tilla	47	41	45	50	52	40	59	50	41
niveli i ulët i ndërgjegjësimit të popullatës lidhur me këtë fenomen	36	47	38	33	43	32	40	41	25
mbështetja e pamjaftueshme për viktimat	30	34	31	28	36	24	40	35	20
lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore	28	28	29	26	45	23	29	32	18
lidhja ndërmjet migracionit të paligjshëm dhe trafikimit	15	17	18	12	18	14	16	19	8
<b>N.</b>	<b>350</b>	<b>1,387</b>	<b>192</b>	<b>158</b>	<b>53</b>	<b>203</b>	<b>94</b>	<b>233</b>	<b>117</b>

**Pyetje ankete:** Çfarë ju shqetëson më shumë? Disa. **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

### Qëndrimet ndaj viktimave

Pothuajse të gjithë (95%) të rinjtë në Tiranë, pak më shumë se popullsia e gjerë (90%), kanë besim të fortë se viktimat e trafikimit duhet të mbështeten (Figura 22).

Figura 22. Niveli i dakordimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar



**Pyetje ankete:** Sa dakord jeni me ofrimin e mbështetjes së posaçme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ose personat në risk për t'u trafikuar? **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Të rejtat në Tiranë (97%) kanë më shumë empati ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë (94%), megjithëse diferenca nuk është domethënëse (Tabela 9). Të rinjtë e moshës 25-29 vjeç janë më empatikë sesa të rinjtë e tjerë ndaj viktimave, (92% of 15–17-vjeçarëve and 95% of 18–24-vjeçarëve) Ndërkohë, nuk ka shumë dallim midis nivelit të ndjeshmërisë të zonave rurale në Tiranë (94%) dhe zonave urbane (96%).**

Tabela 9. Niveli i dakordimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar, sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit(%)

Niveli i dakordimit	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Urbaniteti	
	F	M	15–17	18–24	25–29	Urban	Rural
jashtëzakonisht ose shumë	97	94	92	95	98	96	94
disi	3	6	6	5	2	4	6
pak ose aspak	1	0	2	0	0	0	0
<b>N.</b>	<b>192</b>	<b>158</b>	<b>53</b>	<b>203</b>	<b>94</b>	<b>233</b>	<b>117</b>


**Popullata e synuar:** Tiranë.

#### 4.4 Praktikrat lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

##### Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore

**Të rinjtë e anketuar në Tiranë kanë më shumë interes të mësojnë për trafikimin e qenieve njerëzore (Figura 23) se sa popullata në tërësi e anketuar në katër qarqet.** Më shumë se gjysma e të rinjve (52%) janë shumë të interesuar të mësojnë se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje, krahasuar me 43% të popullatës në tërësi. **Të rinjtë në Tiranë janë më shumë të interesuar të dinë se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje.**


Figura 23. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore



**Pyetje ankete:** Deri në cilën masë jeni i/e interesuar për të mësuar rreth këtyre aktiviteteve? **Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar.** **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

**Të rejtat në Tiranë janë më të interesuara sesa të rinjtë për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore** (Figura 24). Për shembull, 58% e femrave janë të interesuara të mësojnë se si të raportojnë rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore, krahasuar me vetëm 35% të meshkujve; dhe 63% të femrave janë të interesuara të mësojnë se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë apo mbështetje, krahasuar me 40% të meshkujve.

Figura 24. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Të rinjtë në moshë më të madhe (25-29 vjeç) janë më pak të interesuar të mësojnë rreth trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me grupmoshat e tjera**, veçanërisht lidhur me profilin e trafikantëve ose kush mund të jetë trafikant, dhe ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje (Tabela 10).


Tabela 10. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

Çështje të trafikimit të qenieve njerëzore	Grupmosha (vjeç)		
	15-17	18-24	25-29
Kush është në risk për t'u trafikuar	39	46	39
Format e ndryshme të shfrytëzimit	41	33	27
Profilin e trafikantëve ose kush mund të jetë trafikant	48	45	35
Metodat ose taktikat e rekrutimit të viktimave	40	42	33
Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore	42	50	43
Ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë/mbështetje	47	58	41
<b>N.</b>	<b>53</b>	<b>203</b>	<b>94</b>

Tabela paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Të rinjtë e anketuar në zona urbane në Tiranë janë më pak të interesuar se të rinjtë në zona rurale për të mësuar rreth aspekteve më të shumta të trafikimit të qenieve njerëzore** (Figura 25). Për shembull, 45% e personave në zona urbane kanë interes të mësojnë rreth metodave dhe taktikave të rekrutimit të viktimave, krahasuar me 37 për qind të të rinjve në zona rurale.

Figura 25. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas urbaniteti



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

## Interesi për t'u përfshirë në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore

Të rinjtë në Tiranë janë më të interesuar për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata në tërësi (Tabela 11). Ata janë më të interesuar për të raportuar një rast të mundshëm trafikimi të qenieve njerëzore (67%) dhe të informojnë familjarët dhe miqtë e tyre rreth çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore (65%), dhe më pak të interesuar për vullnetarizmin në punën kundër trafikimit të një organizate joqeveritare (OJF) (40%).


Tabela 11. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore (%)

Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore	Total, Tiranë	Totali, 4 qarqe
Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit	63	59
Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë/komunitet	59	55
Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit	65	61
Vullnetarizmi në aktivitetet kundër trafikimit të një OJF-je	40	39
Mbështetja e mblledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit	42	40
Raportimi diku për një viktimë të mundshme trafikimi qeniesh njerëzore	67	59
Raportimi për një të dyshuar si trafikant qeniesh njerëzore	63	57
<b>N.</b>	<b>350</b>	<b>1,387</b>

**Pyetje ankete:** Sa i/e interesuar do të ishit të përfshiheshit në aktivitetet e mëposhtme? Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Tiranë; Totali, 4 qarqe.

Midis të rinjve në Tiranë, femrat janë më të interesuara se meshkujt për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata në tërësi (Figura 26). Për shembull, 70% e femrave janë disi ose shumë të interesuara të angazhohen në diskutime apo aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore në shkollë ose komunitet, krahasuar me vetëm 47% të meshkujve.

Figura 26. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Grupmosha 18-24 vjeç është më e interesuar sesa grupmoshat e tjera** (Tabela 12) sa u përket të gjitha aktiviteteve të parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave.


Tabela 12. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore	Grupmosha (vjeç)		
	15-17	18-24	25-29
Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit	46	70	56
Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet	46	64	54
Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	51	69	64
Vullnetarizmi në aktivitetet kundër trafikimit të një OJF-je	37	44	33
Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit	38	45	37
Raportimi diku për një viktimitë të mundshme trafikimi qeniesh njerëzore	44	77	60
Raportimi për një të dyshuar si trafikant qeniesh njerëzore	40	71	59
<b>N.</b>	<b>53</b>	<b>203</b>	<b>94</b>

Grafiku raporton përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

**Të rinjtë në zona urbane në Tiranë janë më pak të interesuar se të rinjtë në zona rurale të përfshihen në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore** (Figura 27). Dallimet më të theksuara shihen në fushën e vullnetarizmit për punën anti-trafikim të një OJQ-je (ku 54% e të rinjve në zona rurale janë disi ose shumë të interesuar për vullnetarizmin, krahasuar me 33% të të rinjve në zona urbane) dhe në mbështetjen e mbledhjes së fondeve për programet anti-trafikim (përkatësisht 56% dhe 35%).

Figura 27. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas urbanitetit




Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Tiranë.

#### 4.5 Rezultatet e strategjisë së komunikimit të UNICEF-it

Thuajse 24 për qind e të rinjve të anketuar në Tiranë raportuan se janë ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit (Figura 28).<sup>7</sup> Nga këta të rinj, 59% ishin ekspozuar ndaj materialeve nëpërmjet televizionit, 54% nëpërmjet Instagram-it, 45% nëpërmjet diskutimeve në shkollë, 29% nëpërmjet Facebook-ut dhe 26% nëpërmjet broshurave ose materialeve të shtypura.

<sup>7</sup>Kjo i referohet punës së ndërmarrë nga UNICEF Shqipëri dhe partnerët e tij në kuadrin e Programit Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria, nga prilli i vitit 2020 deri në momentin e intervistave të anketës.


Figura 28. Kanalet e ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit për trafikimin e qenieve njerëzore



**Pyetje ankete:** Nëpërmjet cilit kanal të mëposhtëm komunikimi u informuat për ngjarjet, mesazhet ose materialet e komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore? **Disa.** **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Tiranë.

Nga të rinjtë që raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit, **98% raportuan se njohuritë e tyre për trafikimin e qenieve njerëzore ishin shtuar si rezultat i ekspozimit** (8% në masë shumë të madhe, 62% në masë të madhe dhe 27% në një farë mase; Figura 29).


Figura 29. Masa e përmirësimit të njohurive për trafikimin e qenieve njerëzore pas ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit



**Pyetje ankete:** Deri në ç’masë është përmirësuar niveli njohurive tuaja rreth trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Tiranë.

**Për më tepër, 98 për qind e të rinjve të ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit deklaruan se qëndrimet e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore kanë ndryshuar dhe se tani janë të interesuar të luajnë një rol më aktiv në luftën kundër këtij fenomeni** (10% në nivel shumë të lartë, 50% në nivel të lartë dhe 38% disi të interesuar; Figura 30).

Figura 30. Masa e ndryshimit të qëndrimeve pas ekspozimit ndaj materialeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore



**Pyetje ankete:** Deri në ç’masë ka ndryshuar qëndrimi juaj lidhur me përfshirjen më aktive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Tiranë.



## 5. PËRFUNDIME

Ky raport, që paraqet gjetjet kryesore nga anketa e valës së dytë, siguron pikëpamje të vlefshme rreth njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve të anketuar në Tiranë sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore. Këto gjetje do t'u vlejnjë subjekteve anti-trafikim që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të mbrojtjes së viktimave.

Për sa i përket nivelit të njohurive, të dhënat e anketës tregojnë se pjesa më e madhe e të rinjve në Tiranë e dinë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në vende të huaja, edhe pse ka më pak që dinë se trafikimi ndodh dhe brenda Shqipërisë dhe shumë më pak e dinë se ndodh në komunitetin apo zonën e tyre. Te të rinjtë e anketuar, ka më shumë femra sesa meshkuj që e dinë se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore dhe kjo njohuri është më e madhe te më të rriturit dhe ata që jetojnë në zona rurale.

Të rinjtë në Tiranë kanë më pak njohuri se popullata në tërësi për format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë shtetit, veçanërisht për mundësinë e grupeve të tjera përveç vajzave (nën 18 vjeç) dhe minoriteteve kombëtare për t'u bërë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore.

Midis të rinjve në Tiranë, femrat dhe ata që jetojnë në zona rurale dinë më shumë se të tjerët për grupet në risk të trafikimit të qenieve njerëzore.

Të rinjtë në Tiranë kanë njohuri për metodat e rekrutimit dhe për trafikantët e qenieve njerëzore, edhe pse pak prej tyre dinë që trafikantë qeniesh njerëzore mund të jenë dhe anëtarët e familjes. Femrat, 18-24 vjeçarët dhe të rinjtë në zonat rurale kanë më shumë njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore.

Në krahasim me popullatën e përgjithshme të anketuar në 4 qarqet, të rinjtë në Tiranë kanë nivele më të larta njohurish për mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore, dhe femrat dhe të rinjtë në zona rurale kanë më shumë njohuri për mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara se të rinjtë e tjerë.

Përgjithësisht, njohuria për shërbimet e mbështetjes të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është më uniforme te të rinjtë në Tiranë se sa te popullata në tërësi Megjithatë, 26% të të rinjve në Tiranë nuk kanë njohuri për ndonjë tip mbështetjeje të disponueshme, dhe njohuria për një mbështetje të tillë është më e lartë te femrat, të rinjtë e grupmoshave më të reja dhe të rinjve në zona rurale.

Shqetësimi për trafikimin e qenieve njerëzore është më i lartë te të rinjtë në Tiranë se te popullata e anketuar në tërësi në katër qarqet, dhe është më i lartë te femrat, të rinjtë e grupmoshave më të rritura dhe të rinjtë në zona rurale.

Qëndrimet e të rinjve në Tiranë kundrejt viktimave janë pozitive, me 95% që raportojnë se viktimave duhet t'u sigurohet mbështetje. Femra, 25-29-vjeçarët dhe të rinjtë në zona urbane kanë më tepër empati kundrejt viktimave dhe e përkrahin më shumë mbështetjen e tyre.

Në praktikë, të rinjtë në Tiranë janë më të interesuar sesa popullata në tërësi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore. Ata janë më të interesuar të mësojnë se kush mund të jetë trafikant qeniesh njerëzore ose për profilet e trafikantëve të qenieve njerëzore, si dhe të mësojnë se ku mund të drejtohen viktimat për të përfituar ndihmë ose mbështetje. Interesi i femrave, grupmoshës 15-24 vjeç dhe të rinjve në zona rurale për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore është më i lartë.

Të rinjtë në Tiranë janë gjithashtu më të interesuar për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata në tërësi. Femrat, 18-24-vjeçarët dhe të rinjtë në zona rurale janë më të interesuar të përfshihen se të rinjtë e anketuar në kryeqytet.

Pak të rinj në Tiranë (24%) raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të kaluara. Megjithatë, 98% e atyre që raportuan se ishin ekspozuar raportuan edhe njohuri më të shumta rreth fenomenit. Vlen të përmendet se 98% e të rinjve të ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit raportuan ndryshim qëndrimesh ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe interes të shtuar për të luajtur rol më aktiv në luftimin e këtij fenomeni.



Rezultatet e mësipërme tregojnë se subjektet e përfshira në luftën kundër trafikimit duhet t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre te përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore të rinjtë meshkuj e të gjitha grupmoshave, si dhe te të rinjtë në zona urbane në Tiranë. Duhet t'i kushtohet vëmendje përmirësimit të njohurive lidhur me: praninë e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe në Tiranë; të qenit në risk për trafikim qeniesh njerëzore të burrave, djemve dhe të rinjve në zona rurale; format e ndryshme të shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë tij; mundësinë që pjesëtarët e familjes të jenë trafikantë të qenieve njerëzore; theksimin e mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore te subjekte të tjera veç policisë; dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Programet parandaluese mund të synojnë gjithashtu përmirësimin e qëndrimeve të të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, ndërsa programet e ardhshme arsimore mund të përdorin metoda komunikimi të njohura nga të rinjtë e anketuar në Tiranë: përkatësisht mediat sociale, televizioni, bisedat në shkollë dhe materialet e shtypura.

unicef   

---

  
for every child